ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **214-22-12927-1-1-1**

Sa i përket tenderit për **Furnizim me targa për regjistrimin e automjeteve**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	**G.S.G SH.P.K.**
NUI	**601540223**
Adresa	**Ali Pashe Tepelena,IVY Residence,1/16**
Vendi	**PRISHTINE**
Kodi postar	**10000**
Numri Telefonit	**044906902**
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	**Jon Arifi**
Adresa elektronike	**gsgshpk@gmail.com**
Data e parashtrimit të ankesës	**29.03.2023**

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Furnizim me targa për regjistrimin e automjeteve

Njoftimi për kontratë është publikuar me dt.08.12.2022, kurse hapja e ofertave është bërë me dt.20.01.2023 ku kanë ofertuar nëntë operator ekonomik.

Me dt. 09.03.2023 përmes sistemit të E prokurimit kemi pranuar njoftimin mbi vendimin per tenderuesin e eleminuar dhe gjithashtu kemi pranuar edhe vendimin e AK-es per anullimin e procedures se prokurimit.

Me dt. 14.03.2023 përmes sistemit të E prokurimit kemi paraqitur kerkesen per rishqyrtim prane AK-es ndersa me dt. 21.03.2023 kemi pranuar Vendimin ne Kerkesen per Rishqyrtim permes se ciles na eshte refuzuar kerkesa per rishqyrtim si e pabazuar. deshirojme te theksojme faktin se asnje nga pretendimet tona nuk eshte trajtuar gjate kesaj faze. pra AK-es ka injoruar ne teresi faktet dhe provat e pakontestueshme ee paraqitura nga ne.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☒ **Jo** ☐

Hapja e ofertave është bërë me dt.20.01.2023 permes platformes se e-prokurimit, ku kanë ofertuar nëntë operator ekonomik.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ ***Jo*** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Autoriteti Kontraktues nuk ka trajtuar asnje nga pretednimet tona ankimore por vetem ka bere refuzimin e kerekeses sone per rishqyrtim pa i trajtuar fare pretendimet tona.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së-

Neni 7 i LPP-së

Neni 56 i LPP-së

Neni 59 i LPP-së

Neni 60 i LPP-së

Neni 62 i LPP-së

Neni 69 i LPP-së

Neni 72 i LPP-së

Neni 43.5 i Rregullores Nr.001/2022 për prokurim publik

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Në arsyen e parë të eliminimit, AK-es i eshte referuar test raportit nga ZAG me numër 47/23-461-3-EN.

Në lidhje me këtë dokument AK-es pretendon se është bërë vetëm një përshkrim që i referohet një test raporti të vitit 2018, mirëpo AK-es ka injoruar faktin se ZAG ka bere ri-konfirmimin mbi ate testim dhe meqenese materjali nuk ka pesuar ndryshime atehere ata kane bere vazhdimin e validititeti te ketij test raporti. Pra laboratori ka shtuar konfirmimin e tij me dt 19.01.2023 dhe ka konfirmuar se materjali i testuar eshte ne pajtim me standartin ISO 7591. Por vlen te theksohet se ky test raport te cilit AK-es i referohet eshte vetem nje dokument shtese ne lidhje me kerekesen e dosjes se tenderit sepse ne si OE përkitazi me këtë kërkesë, kemi bashkangjitur test raportin e dt.22.09.2020 me nr: ref:

1140-2/1894783071/20 të lëshuar nga DEKRA Automobil GmbH i cili është laborator i akredituar për të kryer testime dhe certifikime për standardin ISO 7591, dhe ne këtë raport te lëshuar nga DEKRA është e shkruar qarte se mostra është testuar konform pikës 10 te aneksit 1, me saktësisht **është testuar ne pajtim me standardin ISO 7591, pjesa 8, 12, 13, 14 dhe 15**.

Gjithashtu ne kemi kërkuar edhe një sqarim nga Dekra në lidhje me këtë pretendim, dhe pikërisht nga ata na është konfirmuar se test raporti me nr: ref: 1140-2/1894783071/20 konfirmon gjithashtu edhe përputhshmërinë e shtresës me stampim te nxehtë ashtu siç kërkohet ne piken 10 te Aneksit 1. Po ju citojm pergjigjen e Dekra GmbH ne lidhje me test raportin e dt.22.09.2020 me nr: ref: 1140-2/1894783071/20:

"*ISO has no special requirements for the font and the colors of the letters. The lighting technology*

and colorimetric information/requirements listed in the standard only apply to the reflective film. If one font and one color of letters (hot stamping foil) compatible, generally follows from the others

testing of the standard, i.e. from sections 8 to 16. And since the report shows the standard conformity of the signs with ISO 7591 is certified, ***is at the same time also certified that the font and the coloring also automatically conform to the standard are equivalent to***".

Pra nese AK-es ka pasur dyshime mbi kete qeshtje, eshte dashur ti drejtohet Dekra GmbH per sqarime sepse ju konfirmojme me pergjegjesi te plote se ky test raport dëshmon që prodhimi i targave (mostrave) për regjistrim te automjeteve dhe karakteristikat teknike te targave janë në përputhje me standardet ISO 7591 dhe specifikimeve teknike te dosjes se tenderit, prandaj arsyeja e eliminimit është e pabazuar. Gjithashtu ne kemi bashkangjitur edhe test certifikatën nga DEKRA te leshuar per prodhuesin, ku shkruan se përmbushen kërkesat e ISO 7591, prandaj arsyeja e eliminimit është e pabazuar plotësisht. Ju lutemi qe si deshmi per permbushje te kesaj kerkese te merret raporti i Dekra ashtu siq edhe e kemi shkruar ne dosje te tenderit.

Në lidhje me arsyen e dytë të eliminimit ku është cekur se kemi dorëzuar një mostër të targës me numër 01 444 AD, ju sqarojmë se në nenin 9.1&9.2 të FDT-së, kërkesa Nr.2 është kërkuar si në vijim:

"*2.Operatori ekonomik është i obliguar që për targat me të cilat ofertojnë duhen ta dorëzojnë një mostër të targës së rëndomtë e cila është në përdorim, me dimensione 520 x 110 mm së bashku me përshkrimin e specifikimeve teknike. Nëse nuk dorëzohet dhe përshkrimi i specifikimeve teknike te mostrës oferta nuk do te merret ne shqyrtim dhe do te konsiderohet oferte e pa përgjegjshme. nuk është e obligueshme që ti kenë masat e veçanta të sigurisë, por duhet jenë ne harmoni me kualitetin e materialeve për prodhimin e targave sipas specifikave teknike te dhëna ne Aneksin 1 të Dosjes së tenderit, kurse dëshmi e kërkuar dokumentare "2. Një mostër të targës me dimensione 520 x 110mm, sipas specifikimeve teknike te targave te dorëzohen fizikisht para hapjes se ofertave, në*

një zarf të mbyllur".

Pra siç shihet nuk është kërkuar që të dorëzohet targa (mostra) me kombinimin e numrave 01 999 AD por është kërkuar mostër e targës së rëndomtë e cila është në përdorim dhe me dimensionet 520 x 110 mm së bashku me përshkrimin e specifikimeve teknike, dhe ne kemi ofertuar dhe dorëzuar mostrën konform kërkesave të FDT-së dhe të njoftimit për kontratë. Një kërkesë e tillë nuk është përcaktuar as tek përgjigjet e dt. 05.01.2023 të cilave ju po i referoheni.

Ju rikujtojmë se pyetja ishte parashtruar si në vijim, citoj: "*CILES SKICE DUHET TI PERMBAHEMI*", ndërsa përgjigja juaj ka qenë si në vijim, citoj: "***SIPAS DIZAJNIT GRAFIK SKICA FAQE 01 TE NGARKUAR NE PLATFORMEN E PROKURIMIT TE DT 05.01.2023***".

Pra pyetja e edhe përgjigja juaj i referohen skices dhe permasave të targës me format 52 x 11 cm dhe jo kombinimit te numrave dhe shkronjave siq ju pretendoni, prandaj mostra që OE është dashur ta dorëzojnë është dashur të jetë një targë e rëndomtë me dimensione 52x11cm (sepse ka mund të kërkohet edhe mostër me dimensione tjera siç është psh: targa katrore me dimensione 34x20cm) dhe askund nuk flitet për kombinimin e numrave dhe shkronjave siç po pretendoni AK-es.

Ne kemi dorëzuar mostrën me kombinim te numrave dhe shkronjave 01-444-AD dhe e cila është në përputhshmëri të plotë me skicen dhe me parametrat e targës me format 52x11cm dhe gjithashtu është ne pajtueshmëri të plotë edhe me "Numrat dhe shkronjat e targave" ku janë të paraqitura numrat nga 0 deri tek 9 dhe germat nga A deri tek Z, pra një targë e rëndomtë është çfarëdo targe me kombinim e këtyre numrave dhe shkronjave.

Ju rikujtojmë se edhe në të kaluarën OE të ndryshëm kanë dorëzuar mostra me kombinime të ndryshme numrash dhe shkronjash dhe asnjëherë nuk kemi hasur në ndonjë arsye të tillë të eliminimit.

Pra mostra është kërkuar që të dorëzohet e rëndomtë dhe nuk ka pas ndonjë kërkesë tjetër që mostra te përmbaj nje kombinim te caktuar, prandaj me këtë rast kuptohet që AK-es ka vepruar në kundërshtim me nenin 56.3 të LPP-së sepse ne jemi eleminuar për një kërkesë që nuk ka qenë e specifikuar në dosje të tenderit, kurse neni 56.3 i LPP-së shkruan shumë qartë "*Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit*".

Në lidhje me arsyen e tretë të eliminimit, ju sqarojmë se trashësia e materialit bazë është pikërisht sipas kërkesës së dosjes së tenderit, nëse matet materiali bazë ashtu siç duhet të matet, mirëpo kur matet me materialin reflektues atëherë është e kuptueshme se trashësia

del më e madhe.

Ne edhe nga shikimi i mostrave gjatë qasjes në dokumente e kemi vërejtur se mostrat nuk janë prishur apo dëmtuar fare sepse matja është bërë edhe me material reflektues në të kundërtën nëse matja do të ishte bërë pa të, atëherë mostra do duhej të dëmtohej dhe do ishin vërejtur shenja në të.

Trashësia e materialit bazë të ofruar nga ne është 1mm e jo siç pretendohet nga AK-es se kinse është 1.342mm dhe atë sipas verifikimit të mostrës nga laboratori i forenzikës.

Tek specifikimet teknike është kërkuar decidivisht si në vijim:

1. Materiali bazë

1.1 Alumin 1 mm i trashë Toleranca +/- 0.03mm

EN 1396:2007 Vetitë mekanike për shtresën.

Alumin EN AË 1050 H42 ose EN AË 1200 H42 Shtresa mbrapa aluminit të targës të jetë e mbrojtur me llak transparent.

Për më tepër forenzika nuk është kompetente për matjen e materialeve të tilla, prandaj nuk duhet të merren parasysh këto matje. Apo mund të jetë lëshimi tjetër eventual që autoritet kontraktues nuk i ka sqaruar forenzikes mirë dhe qartë se cilat materiale duhet të maten, **vetëm materiali baze** apo së bashku me materialin reflektues-foli.

Për te vërtetuar dhe sqaruar detajisht edhe trashësinë edhe procedurën e matjes se materialit bazë po **ju bashkëngjisim një test-raport te kryer me dt. 10.03.2023 nga laboratori ZAG** për një moster e cila është identike me materialin e përdorur për mostrën e dorëzuar tek AK-es.

METHOD AND RESULTS OF THE MEASUREMENTS

The thickness was performed using a mechanical measuring
Mitutoyo, model IDC-125B. Diameter of the planar gauge head

Test results are given in the Table 1 below.

Table 1: Results of the testing of the registrat

	Determined thic (mm)
Aluminium plate without retroreflective sheeting	1.001
Aluminium plate with retroreflective sheeting	1.228

Figure 1: Measuring points for thickness det

CONCLUSION

Sa i përket pretendimit tjeter se kinse mostra nuk përmban shenjën RKS në anën e majtë në formë periodike vertikalisht, ju sqarojmë se ky pretendim është në kundërshtim me specifikat e dosjes së tenderit. Askund në dosje të tenderit as tek specifikacionet teknike as tek sqarimet e përgjigjeve të dt. 05.01.2023 nuk përcaktohet dhe kërkohet që mbishkrimi RKS në anën e majtë duhet të jetë në formë periodike vertikalisht dhe as nuk ekziston ndonje pershkrim ose ngjyre ose permas qe e percakton ate, ndërsa tek skicat dhe parametrat e targave është përcaktuar që akronimi i Republikës së Kosovës të jetë vetëm në anën e majtë të tabelës me ngjyre Ari (Gold) dhe me lartesi 19mm, e ashtu edhe mostra jonë e përmban atë. Sa për sqarim, specifikacionet teknike, skicat dhe formati i targave RKS është i pandryshueshëm qe nga viti 2008 e deri me sot dhe kjo është shume lehtë e verifikueshme dhe theksojme se ne gjdo here para fillimit te prodhimit te targave jemi konsultuar me AK-es dhe ne tenderin e pare qe kemi pasur na eshte konfirmuar nga njesia kerkuese qe shkronjat te cilave ju po i referoheni jane VETEM SI NDIHMESE PER TE PERCAKTUAR SE KU DUHET TE POZICIONOHET AKRONIMI RKS ashtu siq jane edhe katroret dhe X-at ne kete vizatim. Gjithashtu kompania jone është prodhuesi i më shumë se 1.5 milion targave RKS për llogari te MPB-se dhe asnjëherë ne nuk kemi hasur një kërkesë të tillë as në ndonjë dosje e as nga menaxheret e kontratave. Meqenëse ne edhe në të kaluarën kemi pasur kontrata, ndërsa edhe tani kemi kontrate valide me MPB-ne për furnizim me targa, jemi shumë te bindur se nuk ka ndodhur asnjë ndryshim tek skicat dhe formati i targave. Pasi që specifikacionet teknike, skicat dhe formati i targave janë identike me tenderin paraprak të cilin ne e kemi në realizim, atëherë sipas konstatimit te forenzikës do duhej që specifikimet teknike të jenë ndryshuar ne këtë tender ose nëse këto specifika nuk janë ndryshuar, atëherë i bie se të gjitha furnizimet që ne kemi bërë për MPB-se deri me sot janë në kundërshtim me formatin dhe skicat e targave. Pra thënë ndryshe me këtë konstatim të forenzikes i bie që të gjitha targat që janë në qarkullim janë në kundërshtim me specifikacionet teknike, skicat dhe formatin e targave. Për të konfirmuar edhe më shumë se skicat dhe formati i targave nuk ka asnjë ndryshim me tenderin paraprak, ju lutem ti referoheni te gjitha dosjeve paraprake dhe gjithashtu edhe ekspertizave paraprake te forenzikes, dhe do të bindeni që edhe ky pretendim është absolutisht i
pabazuar.

Skica dhe parametrat e targave (Formati 52x11 cm)
Outline and parameters of the plates (Format 52x11 cm)
Skice i parametri za tablice (Format 52x11 cm)



Operatorët ekonomik që janë më të lirë se ne janë të papërgjegjshëm dhe arsyet do ti cekim më poshtë.

Erich Utsch AG;Horn&CO.Kosova SHPK është i papërgjegjshëm:

Ky OE nuk e ka vendos shenjën RKS tek shenjat drejtuese të sigurisë, ndërsa tek specifikimet teknik është kërkuar: **4.1** Shiritat me ngjyrë të zezë për shkronja dhe numra, detyrimisht duhet të kenë shenjen RKS të përsëritur periodikisht në të gjithë gjatësinë dhe gjerësinë e tyre.

Gjithashtu tek specifikimet teknike është kërkuar: **4.2** Në brendësinë e targës në anën e prapme të jetë data e porosisë.

Mostra e OE e të lartpërmendur nuk e përmban datën e porosisë në anën e prapme.

Gjithashtu edhe sigurimi i tenderit i paraqitur nga ky OE eshte i paekzekutueshem ne Republiken e Kosoves sepse i njejti eshte i leshuar nga nje banke e pa licencuar ne Kosove dhe si e tille do duhej te veprohej konform rregullores se BQK-se per leterkredine dhe garancionin bankar. Ju lutemi ti referoheni edhe inteerpretimit te leshuar nga KRPP per qeshtje te tilla.

Europrinty është i papërgjegjshëm:

Ky OE nuk ka dorezuar fare moster dhe as nuk ka dorezuar sigurimin e tenderit andaj eshte administrativisht i papergjegjem dhe nuk kalon fare ne vleresim.

IDK KONSTRUKSION SHPK është i papërgjegjshëm:

Ky OE nuk ka permbushur kerkesat mbi mundesite teknike dhe profesionale specifikisht piken 2 dhe 3 sepse tek specifikimet teknike është kërkuar: **4.2** Në brendësinë e targës në anën e prapme të jetë data e porosisë. ndersa mostra e OE e të lartpërmendur nuk e përmban datën e porosisë në anën e prapme dhe gjithashtu test raporti i prezantuar deshmohet se eshte i leshuar nga nje laborator i cili nuk eshte i akredituar per te bere testime konform ISO 7591.

Operatorët ekonomik që janë më të lirë se ne janë të papërgjegjshëm dhe arsyet do ti cekim më poshtë.

CETKOS L.L.C;Utal Spz.o.o është i papërgjegjshëm:

Ky OE nuk ka permbushur kerkesat mbi mundesite teknike dhe profesionale specifikisht piken 3 sepse test raporti i paraqitur nuk eshte konform kerkesave te dosjes se tenderit dhe gjithashtu ky OE ka paraqitur sigurimin e tenderit i cili eshte i paekzekutueshem ne Republiken e Kosoves sepse i njejti eshte i leshuar nga nje banke e pa licencuar ne Kosove dhe si e tille do duhej te veprohej konform rregullores se BQK-se per leterkredine dhe garancionin bankar. Ju lutemi ti referoheni edhe inteerpretimit te leshuar nga KRPP per qeshtje te tilla.

EGO ELSA & RADE KONCAR është i papërgjegjshëm:

Edhe pse eshte me cmim me te shtrejt se ne, deshirojme te atakojme vleresimin e AK-es ne raport me kete OE sepse jemi te bindur qe ky OE nuk arrin ta permbushe Kërkesen mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, perkatesisht piken 2 dhe 3 te FTD-se. Oferta e ketij OE ishte konfidenciale dhe ne pamundesi per te shikuar dokumentacionin e tyre ne kerkojme nga OSHP qe te bej ekspertize te drejte te ofertave dhe te kete parasysh Nenin 7 te LPP-se sepse te gjithe OE duhet te trajtohen te barabarte dhe pa diskriminime.

Nga sa u sqarua më lartë, kuptohet që ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në pajtimi me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së, pasi që ne është dashur të shpallemi fitues të kësaj kontrate sepse i plotësojmë të gjithë kërkesat e dosjes së tenderit dhe specifikimet teknike.

Në procedurë të vlerësimit të ofertave nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-së, përkatësisht paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së ku parashihet që *"Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente*. Në këtë procedurë ne jemi diskriminuar, duke u eliminuar me arsye të pabaza dhe të paqëndrueshme.

Edhe pse ne i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe specifikimet teknike, kur eventualisht AK-ja ka ndonjë paqartësi mund të shfrytëzojë nenin 59.2 dhe 72 të LPP-së për ndonjë sqarim eventual, kurse në këtë janë anashkaluar në tërësi këto dispozita.

Kur kemi parasysh të gjitha elaborimet dhe sqarimet që u bënë më lartë, me argumente konkrete kuptohet qartë që anulimi i kësaj procedure të prokurimit është bërë në kundërshtim të plotë me nenin **62 të LPP-së** dhe në kundërshtim me nenin 43.5 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik, pasi që nuk janë përmbushur asnjëra nga kushtet e përcaktuara në këto dispozita, sepse ne jemi ofertues i përgjegjshëm dhe është dashur të vazhdohet me procedurat e mëtutjeshme.

AK nuk e ka respektuar as nenin 1 të LPP-së, kur dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke pasur parasysh pretendimet e argumentuara, i propozojme OSHP-se të nxjerr:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE **G.S.G SH.P.K & KIG d.d,**

ANULOHET njoftimi mbi vendimin e AK-së dhe lënda kthehet në **RIVLERESIM** dhe gjatë rishqyrtimit, ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit te ofertave të bëhet vetem në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës jane në vlerë te

konsiderueshme.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*